



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 tetor 2021
Nr. ref.:RK 1867/21

VENDIM PËR REFUZIM

në

rastin nr. KI121/21

Parashtrues

Bajram Hasani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 42-2021, të 11 janarit 2021
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bajram Hasani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin nr. 42-2021, të 11 janarit 2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të KQZ-së, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 1 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 8 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 12 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës, përmes postës elektronike kërkoi nga Gjykata të njoftohet për rastin e tij, dhe kërkoi procedim të shpejtë të rastit të tij.
8. Më 13 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës, bashkëngjiti (i) formularin e zbrazët të aplikimit jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale; (ii) formularin e zbrazët të aplikimit jashtë Kosovës për Zgjedhjet Parlamentare.
9. Më 16 korrik 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi KQZ-në për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës.

10. Më 19 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës, dërgon dy letra. Përmes të parës, kërkon kthim në gjendje të mëparshme, dhe përmes të dytës kërkon që rasti i tij të trajtohet me urgjencë sepse ngrit çështje serioze kushtetuese.
11. Më 22 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës, kërkon nga Gjykata informata se a është njoftuar KQZ-ja lidhur me rastin e tij.
12. Më 11 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës thekson se ka filluar periudha e regjistrimit për votuesit jashtë Republikës së Kosovës, andaj kërkon që rasti i tij të trajtohet me prioritet të lartë.
13. Më 16 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës njofton Gjykatën se me 7 korrik 2021, është shfuqizuar Vendimi nr.42/2021 i 11 janarit 2021, i KQZ-së.
14. Më 24 gusht 2021, Gjykata kërkoj informacion nga parashtruesi i kërkesës (i) të tregojë vendbanimin e tij; (ii) të bashkëngjisë dokumente që dëshmojnë se ai jeton jashtë Republikës së Kosovës; dhe (iii) të bashkëngjisë dokumente që dëshmojnë se ka aplikuar për të votuar.
15. Më 25 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike theksoi se jeton në Lucern të Zvicrës. Ai nuk bashkëngjiti dokumentet e kërkuara nga Gjykata që dëshmojnë se ai jeton jashtë Republikës së Kosovës, me arsyetimin se ka të dhëna personale që munden të ardhmen të dëmtohej integriteti personal, dhe lidhur me dëshminë se ka aplikuar për të votuar, thekson se të njëjtën nuk e posedon sepse e ka dërguar për KQZ.
16. Më 1 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës dërgoi edhe një urgjencë duke theksuar se do mbahen zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.
17. Më 17 shtator 2021, dhe 21 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës bashkëngjiti një Aktvendim të Gjykatës Supreme dhe të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, të dyja këto të një pale tjetër, dhe jo të parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se *“shterja e mjeteve juridike është në dispozicion”*.
18. Më 23 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.
19. Po të njëjtën ditë, Gjykata pranoi kërkesa nga dy organizata për t’u regjistruar si palë e interesuar në rastin KI121/21. Duke pasur parasysh që Gjykata ka vendosur që kërkesa është e paplotë, Gjykata nuk i shqyrtoi kërkesat e tyre.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 11 janar 2021, KQZ nxori Vendimin 42-2021, për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve Jashtë Kosovës. Me këtë Vendim u vendos që (i) prej një e-mail adrese, aplikuesi mund të aplikojë për vete dhe për rrethin e ngushtë familjar, që kanë të njëjtin mbiemër; (ii) në formularët e aplikimit për regjistrim,

aplikuesi duhet të shënojë vetëm numrin e tij të telefonit dhe jo të ndonjë familjari; (iii) KQZ-ja do të verifikoj procesin e aplikimit për regjistrim, duke i kontaktuar të gjithë aplikuesit përmes telefonit; (iv) nëse aplikuesi nuk lajmërohet në telefon, atëherë aplikacioni i tij do të refuzohet; (v) ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

21. Më 14 shkurt 2021, u mbajtën Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Kosovës.
22. Më 7 korrik 2021, u shfuqizua Vendimi nr.42/2021 i 11 janarit 2021, i KQZ-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi i KQZ-së nr.42-2021, i 11 janarit 2021, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të përcaktuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit 1, të KEDNJ-së.
24. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se arsyeja e paraqitjes së kësaj ankese kushtetuese është se kjo kërkesë *“ka të bëjë me të drejtën e votës e cila kjo garantohej edhe me nenin 96 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (ky nen ka të bëjë me votën përmes postes). Mua mu shkel e drejta e votës përmes postes, ku jam telefonuar edhe me numra anonime, në ditën kur me kishte telefonuar KQZ-ja për regjistrim për aplikim për vote, jam telefonuar me numër anonim, duke mos e ditur. Pra, KQZ-ja duke aplikuar në këtë lloj instance, ka shkelur të drejtën time për votë, Kushtetuta dhe Ligjet i garantojnë çdo qytetari të drejtën e votës, të drejtën për zgjedhje të lira, zgjedhje demokratike dhe zgjedhje me përkushtim të lartë demokratik.*
25. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson se *„Votuesve jashtë Republikës së Kosovës iu cënohet e drejta për votim.”*
26. Sa i përket shterimit të mjeteve juridike parashtruesi i kërkesës, thekson: *“kam pasur brengë të mos i drejtohem Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa me arsyetimin se do shtyhej apo pezulloheshin zgjedhjet, përmes të cilës u caktua data 14 shkurt 2021”.*

Kërkesa për kthimin në gjendje të mëparshme

27. Parashtruesi i kërkesës duke u bazuar në nenin 50 [Kthimi në gjendje të mëparshme] të Ligjit, thekson se nuk ka dorëzuar kërkesën brenda afatit sepse *“ka pasur brengë që do pezulloheshin zgjedhjet (në rast se do e parashtronte kërkesën para datës 14 shkurt 2021), në rast se do e parashtronte kërkesën pas 14 shkurtit 2021, ka pasur brengë se në rast se Gjykata Kushtetuese do jepte vendim në muajin mars (kur janë numëruar votat e dorëzuara me postë), atëherë do të mund të shpallej Vendimi nr.42/2021, i KQZ-së kundër-*

kushtetues dhe i pavlefshëm, e në lidhje me këtë, votat do ishin të pavlefshme”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

30. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”

[...]

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

31. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata thekson se bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit, përpos specifikimit të aktit konkret të autoritetit publik i cili kontestohet, palët janë gjithashtu të detyruara që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës, përkundër kërkesës së Gjykatës për informata shtesë, i njëjti vetëm ka treguar vendbanimin e tij, por nuk ka (i) bashkangjitur dokumente që dëshmojnë se ai jetoni jashtë Republikës së Kosovës; dhe (ii) nuk ka bashkangjitur dokumente që dëshmojnë se ka aplikuar për të votuar.

32. Parashtruesi i kërkesës, nuk bashkëngjiti dokumentet e kërkuara nga Gjykata që dëshmojnë se ai jeton jashtë Republikës së Kosovës, me arsyetimin se ka të dhëna personale që mundën të ardhmen të dëmtohej integriteti personal, dhe lidhur me dëshminë se a ka aplikuar për të votuar, thekson se të njëjtën nuk e posedon sepse e ka dërguar për KQZ përmes postës.
33. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që në formularin e kërkesës parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se e drejta e tij në votë ishte cenuar sepse KQZ-ja e kishte telefonuar me numër anonim, dhe ai nuk e kishte ditur. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës kishte kërkuar kushtetutshmërinë e Vendimit nr. 42-2021, të 11 janarit 2021 të KQZ-së, të cilin Vendim ai e pranon se nuk e ka sfiduar pranë gjykatave të rregullta. Gjykata rikujton se Vendimi i kontestuar i KQZ-së, përcakton modalitetet për verifikimin e aplikacioneve për regjistrim për periudhën e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Republikës së Kosovës. Në formularin e tij parashtruesi kishte bashkangjitur vetëm vendimin e kontestuar dhe një shkresë nga atëherë u.d. Presidentja e Republikës së Kosovës drejtuar Kryetares së KQZ-së.
34. Duke u nisur nga fakti, që ky vendim i KQZ-së prekë specifikisht votuesit jashtë Republikës së Kosovës, dhe parashtruesi i kërkesës pretendon se është njëri nga ata, duke theksuar se *“Mua mu shkel e drejta e votës përmes postes, ku jam telefonuar edhe me numra anonime, në ditën kur me kishte telefonuar KQZ-ja për regjistrim për aplikim për vote, jam telefonuar me numër anonim, duke mos e ditur”*, Gjykata kërkoj nga ai të dëshmojë se ai jeton jashtë Republikës së Kosovës, dhe të dëshmojë se ai ka aplikuar për të votuar. Më 25 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës, përmes postës elektronike dërgoi një përgjigje në Gjykatë, mirëpo duke mos e ofruar dokumentet e kërkuara nga Gjykata.
35. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafit (5) të rregullit 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35

(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

“(5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën.”

[...]

36. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës, i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtruesi është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse. Gjykata i është drejtuar parashtruesit të kërkesës me një kërkesë për të plotësuar atë, mirëpo edhe pse parashtruesi i kërkesës kishte kthyer përgjigje

ai nuk ishte përgjigjur në asnjërën nga kërkesat specifike të Gjykatës, siç është sqaruar në procedurën para Gjykatës të këtij Vendimi. Parashtruesi i kërkesës nuk qartësoi saktësisht dhe në mënyrë adekuate faktet dhe pretendimet lidhur me rastin tij, dhe nuk plotësoi rastin e tij siç u kërkuar nga Gjykata.

37. Prandaj, Gjykata duhet të konstatojë se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë, siç është përcaktuar në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.
38. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i refuzon këto kërkesa me procedurë të shkurtër. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI 60/20, parashtrues: *Këshilli i Bashkësisë së Fesë Islame*, Vendim për refuzim i 18 shkurtit 2021, paragrafi 36; KI90/20, me parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 25; dhe rastet nr. KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, me parashtrues *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 7 dhjetorit 2020, paragrafi 33 dhe referencat e përdorura aty).
39. Përfundimisht, në përputhje me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Bajram Ljati



Resa Caka-Nimani